

(MOS) TRANSPARENCA NË QEVERISJE

(Analizë e nivelit të transparencës së Zyrës së Presidentit,
Kuvendit dhe Qeverisë)



Autor: Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)

Me kontribut të: Aurela Mërlaku dhe Nuraje Bllaca

Redaktor: Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështje të Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD


IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Dhjetor, 2022
Prishtinë, Republika e Kosovës

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

LISTA E SHKURTESAVE

AIP

Agjencia për Informim dhe Privatësi

Ministria për Komunitete dhe Kthim

MKK

IKD

Instituti i Kosovës për Drejtësi

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

MKRS

MAPL

Ministria e Administrimit të
Pushtetit Lokal

Ministria e Mbrojtjes

MM

MAShT

Ministria e Arsimit, Shkencës,
Teknologjisë dhe Inovacionit

Ministria e Mjedisit, Planifikimit
Hapësinor dhe Infrastrukturës

MMPHI

MBPZhR

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe
Zhvillimit Rural

Ministria e Punëve të Brendshme

MPB

MD

Ministria e Drejtësisë

Ministria e Punëve të Jashtme
dhe Diasporës

MPJD

ME

Ministria e Ekonomisë

Ministria e Shëndetësisë

MSH

MFPT

Ministria e Financave, Punës
dhe Transfereve

Ministria e Zhvillimit Rajonal

MZhR

MINT

Ministria e Industrisë,
Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Zyra e Kryeministrit

ZKM

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	5
2. Metodologjia	6
3. Zyra e Presidentit	7
4. Kuvendi	7
5. Qeveria	7
5.1. Transparenca e Qeverisë	7
5.2. Zbatimi i Rregullores për Konsultime Publike	15
6. Ministritë më transparente	18
7. Ministritë më jo-transparente.....	18
8. Shtojcat	20
8.1. Shtojca 1: Rangimi i institucioneve sipas transparencës.....	20
8.2. Shtojca 2: Indikatorët e aplikuar për matjen e transparencës.....	21

1. Përmbledhje ekzekutive

Qeveria aktuale ka ardhur në pushtet me premtimin për “qeverisje radikale”. “Qeverisja jonë do të jetë e hapur dhe transparente para qytetarëve, mediave dhe organizatave të shoqërisë civile. Iniciativat dhe vendimet qeveritare do t’i bëjmë të qasshme për publikun dhe do t’i konsultojmë me të gjitha palët e interesit. Do të plotësojmë kornizën ligjore për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së financimit të subjekteve politike dhe menaxhimin e mbrojtjes së informacionit të klasifikuar” thuhet në Programin Qeverisës së Republikës së Kosovës për vitet 2021-2025. Përballë këtyre premtimeve, ligjeve dhe rregulloreve në fuqi dhe nevojës së madhe për transparencë, qeverisja aktuale duket se ende nuk ka arritur standardet minimale të transparencës publike. Aq më pak, një “transparencë radikale”.

Gjetjet e Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), tregojnë për mungesë të transparencës së Zyrës së Presidentit dhe Kuvendit në raport me kërkesat për qasje në dokumente publike. Në shumë raste, e drejta për qasje në dokumente publike është zbatuar vetëm pas inkuadrimit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP).

Sa i përket Qeverisë, në faqet zyrtare të shumë prej dikastereve qeveritare mungojnë të dhënat dhe dokumentet bazë, derisa Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) nuk ka faqe zyrtare. IKD gjen se në 66.6% të institucioneve qeveritare janë emrat dhe kontaktet e zyrtarëve për qasje në dokumente publike derisa këto të dhëna mungojnë në 33.3% të institucioneve. Mungesë e theksuar e transparencës së institucioneve qeveritare vërehet në raport me publikimin e vendimeve të ministrave. Nga të gjitha institucionet qeveritare, vetëm Zyra e Kryeministrit (ZKM) i ka publikuar të gjitha vendimet e nxjerra. Shtatë institucione qeveritare nuk kanë publikuar asnjë vendim në faqet e tyre zyrtare derisa institucionet e tjera vetëm përjashtimisht kanë publikuar vendimet e nxjerra. Përjashtimisht Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), asnjë prej institucioneve të tjera nuk i ka publikuar të gjitha dokumentet në të dy gjuhët zyrtare. 33.3% të dikastereve qeveritare i kanë publikuar të dhënat mbi Ministrat dhe kabinetet e tyre, 46.6% të tyre i kanë publikuar vetëm pjesërisht këto të dhëna, deri 20% të tyre nuk i kanë publikuar fare këto të dhëna.

Në kuptim të zbatimit të obligimeve ligjore dhe veçanërisht premtime për “transparencë radikale”, problematike del të jetë edhe qasja në dokumente publike. Sipas të dhënave të AIP, në 89 raste, dikasteret e Qeverisë së Republikës së Kosovës në kërkesat për qasje në dokumente publike nuk kanë kthyer përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj. Ndërsa, në 71 raste, këto institucione kanë kthyer përgjigje vetëm pas vendimit të nxjerrë nga AIP.

Nëse i shohim të dhënat në tërësi, se në sa raste dikasteret qeveritare kanë publikuar projekt koncept dokumentet dhe projekt aktet normative në platformën e konsultimeve publike dhe kanë respektuar afatin minimal prej 15 ditëve, i bie se dikasteret e Qeverisë së Republikës së Kosovës këtë e kanë bërë në 48% të rasteve, derisa kjo nuk ka ndodhur në 52% të rasteve të tjera. Këto të dhëna flasin për mungesë të transparencës në fushën e politikë-bërjes. Mos përfshirja adekuate e publikut në mbi gjysmën e projekt koncept dokumenteve dhe projekt akteve normative krijon përcepion për mos interesim të publikut për përfshirje të publikut të gjerë në politikë-bërje.

2. Metodologjia

Me qëllim të matjes së transparencës së institucioneve, IKD ka ndërtuar një metodologji të thjeshtëzuar për të matur transparencën e përgjithshme të institucioneve. Indikatorët në fjalë janë nxjerrë kryesisht nga Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe nga Rregullorja (QRK) Nr.05/L-2016 për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik. Këta indikatorë, janë përfshirë në shtojcën 2 të këtij raporti.

Sa i përket rangimit të institucioneve, kalkulimi i pikëve, për indikatorët 1, 2, 4, 5, 8 dhe 9, të paraqitur në shtojcën 2, është bërë në këtë mënyrë: Obligim i përmbushur – 2 pikë, pjesërisht i përmbushur – 1 pikë dhe i papërmbushur 0 pikë. Me qëllim të shmangies së llogaritjeve abstrakte, për disa indikatorë, është bërë poentim më i përshkallëzuar i vlerës së indikatorit. Kështu, për indikatorin 3, vlerësimi është bërë në këtë mënyrë: 0% deri në 20% - 0 pikë, 21% deri në 40% 1 pikë, 41% deri në 60% 2 pikë, 61% deri në 80% 3 pikë dhe 81% deri në 100% 4 pikë. Sa i përket indikatorit 6 dhe 7, poentimi është bërë në këtë mënyrë: 0 raste – 4 pikë, 1 deri në 4 raste 3 pikë, 5 deri në 8 raste 2 pikë, 8 deri në 12 raste 1 pikë, deri mbi 12 raste 0 pikë.

Indikatorët janë aplikuar në mënyrë uniforme ndaj të gjitha institucioneve që janë pjesë e vlerësimit të këtij raporti, përkatësisht Zyrës së Presidentit, Kuvendit dhe Qeverisë. Në rastin e Qeverisë, janë aplikuar dy kritere shtesë sipas Rregullores (QRK) Nr.05/L-2016 për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik.

Burimi primar i të dhënave të këtij raporti janë faqet zyrtare të institucioneve dhe platforma e konsultimeve publike. Përtej kësaj, IKD përmes kërkesave për qasje në dokumente publike ka siguruar disa prej të dhënave statistikore të cilat kanë mundur draftimin e këtij raporti.

Ky raport i referohet transparencës lidhur me të dhënat 1 janar – 5 tetor 2022.

3. Zyra e Presidentit

Në faqen zyrtare të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës janë të publikuara të dhënat bazë në lidhje me këtë institucion si dhe janë të publikuara të dhënat në lidhje me Presidenten dhe Kabinetin e saj.

Por, në këtë faqe, nuk janë të publikuara të dhënat lidhur me zyrtarin për qasje në dokumente publike. Po ashtu, sa i përket qasjes në dokumente publike, në 10 raste, ky institucion nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit të përcaktuar me ligj. Ndërsa, në 10 raste të tjera, qasja në dokumente publike është mundësuar vetëm pas nxjerrjes së vendimit të AIP.

4. Kuvendi

Kuvendi i Republikës së Kosovës në faqen e vet zyrtare i ka të publikuara të dhënat bazë derisa ka të publikuara edhe të dhënat e nevojshme në lidhje me zyrtarin për qasje në dokumente publike. Po ashtu, janë të publikuara edhe të dhënat mbi Kryetarin e Kuvendit dhe Kabinetin e tij.

Në rastin e Kuvendit, shihet se ka probleme në raport me trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike. Kjo pasi sipas të dhënave të AIP, në katër raste, Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit të përcaktuar me ligj derisa në tri raste të tjera, qasja në dokumentet publike është mundësuar vetëm pas nxjerrjes së vendimit të kësaj Agjencie.

5. Qeveria

Në bazë të indikatorëve të përcaktuar, IKD ka matur edhe nivelin e transparencës së Qeverisë, përkatësisht Zyrës së Kryeministrit dhe të gjitha Ministrive. Për dallim nga rastet e tjera, në rastin e Qeverisë, është monitoruar edhe niveli i Zbatimit të Rregullores për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik.

Me këtë rast, vlerësimi nuk është bërë vetëm në raport me MKK. Kjo për faktin se kjo Ministri, në kundërshtim me Ligjin, nuk ka fare faqe zyrtare përmes të cilës publiku mund të informohet mbi kompetencat dhe punën e këtij institucioni qeveritar.

5.1. Transparenca e Qeverisë

Sa i përket të dhënave bazë të institucionit, të gjitha dikasteret qeveritare përmbajnë këto të dhëna. Përfshirë në këtë rast bënë vetëm Ministria e Mbrojtjes (MM) dhe ajo e Zhvillimit Rajonal (MZHR), të cilat vetëm pjesërisht e kanë përmbushur këtë obligim.

Sa i përket zyrtarëve për qasje në dokumente publike, IKD ka hulumtuar nëse institucionet qeveritare kanë të publikuara në faqet e tyre zyrtare emrat dhe kontaktet e këtyre zyrtarëve.

Dhjetë institucione qeveritare kanë publikuar të dhëna në lidhje me emrin dhe kontaktet e zyrtarit për qasje në dokumente publike derisa pesë të tjera nuk e kanë bërë këtë. Shprehur në përqindje i bie se në 66.6% të institucioneve qeveritare janë emrat dhe kontaktet e zyrtarëve për qasje në dokumente publike derisa këto të dhëna mungojnë në 33.3% të institucioneve.

A JANË PUBLIKUAR EMRI DHE KONTAKTET E ZYRTARIT PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE?

ZKM **JO**

MFPT **PO**

MD **PO**

MSh **PO**

MASht **PO**

MKRS **JO**

MAPL **JO**

MMPHI **JO**

MBPZhR **PO**

MM **PO**

MPB **PO**


MINT **JO**

ME **PO**

MKK nuk ka web faqe

MZhR **PO**

MPJD **PO**



Mungesë e theksuar e transparencës së institucioneve qeveritare vërehet në raport me publikimin e vendimeve të ministrave. Nga të gjitha institucionet qeveritare, vetëm ZKM i ka publikuar të gjitha vendimet e nxjerra. Shtatë institucione qeveritare nuk kanë publikuar asnjë vendim në faqet e tyre zyrtare derisa institucionet e tjera vetëm përjashtimisht kanë publikuar vendimet e nxjerra.

PUBLIKIMI I VENDIMEVE TË MINISTRAVE

 Institucioni	Numri i vendimeve të nxjerra nga Ministri	Numri i vendimeve të publikuar	% e publikimit të vendimeve
ZKM	33	33	100%
MFPT	100	13	13%
MD	262	12	4.60%
MSh	108	0	0%
MAShT	89	2	2.40%
MKRS	142	8	5.60%
MAPL	1	0	0%
MMPHI	6	0	0%
MBPZhR	180	4	2.20%
MM	269	0	0%
MPB	123	5	4.06%
MINT	/	0	0%
ME	19	0	0%
MKK	nuk ka web faqe	--	--
MZhR	3	0	0%
MPJD	186	0	0%





Sipas Kushtetutës dhe Ligjit, institucionet qeveritare duhet ta zbatojnë parimin e dygjuhësisë në dokumentet e publikuara. Me këtë rast, IKD ka analizuar nëse në të gjitha dokumentet e publikuara nga dikasteret qeveritare janë publikuar edhe në gjuhën serbe. Në këtë rast, IKD ka gjetur se përjashtimisht ZKM-së dhe MPB-së, asnjë prej institucioneve të tjera nuk i ka publikuar të gjitha dokumentet në të dy gjuhët zyrtare.

Duhet theksuar se publikimi i vendimeve në të dy gjuhët, fillimisht, është obligim kushtetues dhe ligjor. Përtej kësaj, në institucionet e Republikës së Kosovës janë të angazhuar një numër i konsiderueshëm i zyrtarëve serb. Mos publikimi i dokumenteve në gjuhën serbe, gjuhë kjo zyrtare në Republikën e Kosovës, u pamundëson të njëjtëve që të njihen me dokumentet, të cilat potencialisht mund të kenë impakt në punën e tyre.

Tutje, IKD ka analizuar faqet zyrtare të dikastereve qeveritare për të parë nëse në faqet e tyre zyrtare janë të publikuara të dhëna në lidhje me Ministrat dhe Kabinetet e tyre. Në këtë rast, IKD ka gjetur se këtë obligim e kanë përmbushur në tërësi vetëm pesë dikastere qeveritare, shtatë të tjera këtë obligim e kanë përmbushur vetëm pjesërisht derisa në faqet zyrtare të tri dikastereve qeveritare nuk janë fare këto të dhëna. Shprehur në përqindje i bie se 33.3% i dikastereve qeveritare i kanë publikuar të dhënat në fjalë, 46.6% të tyre i kanë publikuar vetëm pjesërisht këto të dhëna, deri 20% të tyre nuk i kanë publikuar fare këto të dhëna.



PUBLIKIMI I TË DHËNAVE LIDHUR ME UDHËHEQËSIT E INSTITUCIONEVE, PËRFSHIRË EDHE KABINETET.

● Të publikuara
 ◐ Pjesërisht të publikuara
 ● Të papublikuara



Në kuptim të zbatimit të obligimeve ligjore dhe veçanërisht premtime për “transparencë radikale”, problematike del të jetë edhe qasja në dokumente publike. Sipas të dhënave të AIP, në 89 raste, dikasteret e Qeverisë së Republikës së Kosovës në kërkesat për qasje në dokumente publike nuk kanë kthyer përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj. Ndërsa, në 71 raste, këto institucione kanë kthyer përgjigje vetëm pas vendimit të nxjerrë nga AIP.

TRAJTIMI I KËRKESAVE PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE.



Në bazë të këtij vlerësimi, IKD gjen se Qeveria e Republikës së Kosovës ende nuk ka plotësuar standardet minimale të transparencës. Kjo në kuptim të obligimeve të përcaktuara me ligj dhe veçanërisht, premtimeve për qeverisje me “transparencë radikale”. Në këtë drejtim, duket se ZKM publikon në masë të madhe dokumentet e nxjerra, të cilat po ashtu publikohen në të dy gjuhët. Por, publikimi i vendimeve të Ministrave është një problem i konsiderueshëm i kësaj qeverie. Publikimi i vetëm 5.8% të vendimeve të nxjerra nga Ministrat qartazi paraqet mos transparencë në Qeverisje.

Për këto arsye, Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të angazhohet që në kuptim të obligimeve të saja ligjore dhe premtimeve qeverisëse, të zhvillojë një qasje proaktive në publikimin e vendimeve dhe dokumenteve të tjera, në mënyrë që mediat, shoqëria civile dhe publiku ta kenë të lehtë qasjen në këto dokumente dhe rrjedhimisht monitorimin e punës së Ekzekutivit.

5.2. Zbatimi i Rregullores për Konsultime Publike

Rregullorja (QRK) Nr. 05/2016 për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik [neni 5] (*Tutje*: Rregullorja) ka përcaktuar se, ndër të tjera, projekt koncept dokumentet dhe projekt aktet normative i nënshtrohen procesit të konsultimit publik. Sipas kësaj rregullore [neni 9.1] konsultimi publik duhet të jetë i hapur për jo më pak se 15 ditë pune. Rregullorja [neni 16] përcakton se shmangie nga kjo rregull mund të ketë vetëm në rastet e emergjencave publike dhe rasteve të tjera të përcaktuara me ligj.

Përgjatë periudhës kohore që mbulon ky raport, sipas përgjigjeve të dikastereve qeveritare, janë miratuar gjithsej 125 projekt koncept dokumente dhe projekt akte normative. Këto akte janë nxjerrë nga të gjitha dikasteret qeveritare, përjashtimisht 2 Ministrive: Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) dhe Ministrisë për Kthim dhe Komunitete.

Nga 125 projekt koncept dokumente dhe projekt akte normative të miratuara nga dikasteret qeveritare, në platformën e konsultimeve publike janë publikuar vetëm 69 prej tyre. Pra, 56 projekt koncept dokumente dhe projekt akte normative janë miratuar pa u zhvilluar fare proces i konsultimit publik. Shprehur në përqindje i bie se përballë obligimit që të gjitha këto akte të publikohen për konsultim publik, dikasteret e Qeverisë e kanë bërë këtë në vetëm 55.2% të rasteve derisa këtë nuk e kanë bërë në 44.8% të rasteve të tjera.



Sa i përket 69 rasteve kur projekt koncept dokumentet dhe projekt aktet normative janë publikuar për konsultime publike në platformën e konsultimeve publike, IKD ka gjetur se afati minimal prej 15 ditëve për konsultime publike është zbatuar në 60 raste, derisa në 9 raste ky afat nuk është zbatuar. Shprehur në përqindje i bie se ky afat është respektuar në 87% të rasteve ndërsa nuk është respektuar në 13% të rasteve¹.

¹ Shënim: Për disa nga projekt koncept dokumente dhe projekt akte normative është zhvilluar konsultimi publik nga Qeveria/të paraprahe. Nisur nga fakti se të gjitha iniciativat kthehen në pikën zero dhe kërkohet miratim/ri miratim i Qeverisë, konsultimi publik, në përputhje me Rregulloren për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik duhet të zhvillohet përsëri. Për miratimin e akteve të reja të cilat bazohen në agjendë të re, nuk mund të konsiderohet i konsumuar procesi i konsultimit public mbi bazën e dokumenteve të kaluara, të bazuara në agjenda legislative të cilat tanimë nuk janë në fuqi.

Nëse i shohim të dhënat në tërësi, se në sa raste dikasteret qeveritare kanë publikuar projekt koncept dokumentet dhe projekt aktet normative në platformën e konsultimeve publike dhe kanë respektuar afatin minimal prej 15 ditëve, i bie se dikasteret e Qeverisë së Republikës së Kosovës këtë e kanë bërë në 48% të rasteve, derisa kjo nuk ka ndodhur në 52% të rasteve të tjera.

Këto të dhëna flasin për mungesë të transparencës në fushën e politikë-bërjes. Rregullorja për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik dhe funksionalizimi i platformës së konsultimeve publike kanë për qëllim ngritjen e nivelit të përfshirjes së publikut në politikë-bërje, në mënyrë që draftimi i politikave të ndjekë një qasje sa më gjithëpërfshirëse. Mos përfshirja adekuate e publikut në mbi gjysmën e projekt koncept dokumenteve dhe projekt akteve normative krijon përcepion për mos interesim të publikut për përfshirje të publikut të gjerë në politikë-bërje.

RESPEKTIMI I RREGULLORES PËR STANDARDET MINIMALE NË PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK NGA DIKASTERET QE VERITARE.



6. Ministritë më transparente

Në bazë të indikatorëve të shpjeguar në metodologjinë e këtij raporti, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), del të jetë dikasteri qeveritar më transparent, e cila ka grumbulluar gjithsej 18 pikë, nga 24 gjithsej. Sipas të dhënave të AIP, në asnjë rast kjo Ministri nuk ka kthyer përgjigje jashtë afatit të përcaktuar me ligj si dhe në asnjë rast qasja nuk në dokumente publike nuk është dhënë vetëm pas vendimit të AIP. Sa i përket Rregullores për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik, kjo Ministri i ka publikuar të gjitha projekt koncept dokumentet dhe projekt aktet normative. Por, kjo Ministri, në 5 nga 11 rastet, nuk e ka respektuar afatin minimal të procesit të konsultimeve publike. Po ashtu, problematike në këtë Ministri është edhe publikimi i vendimeve të Ministrit, të cilat janë publikuar vetëm në raste përjashtimore.

Në vendin e dytë për nga transparenca rangohet MM, e cila ka grumbulluar 17 nga 24 pikë. Kjo Ministri ka publikuar të dhëna lidhur me zyrtarin për qasje në dokumente publike, Ministrin dhe gjithë Kabinetin e Ministrit. Sipas të dhënave të AIP, në asnjë rast kjo Ministri nuk ka kthyer përgjigje jashtë afatit të përcaktuar me ligj si dhe në asnjë rast qasja në dokumente publike nuk është dhënë vetëm pas vendimit të AIP. Në secilin rast, kjo Ministri ka publikuar dokumentet, projekt koncept dokumentet dhe projekt aktet normative në platformën e konsultimeve publike si dhe ka respektuar afatin e konsultimeve publike, të përcaktuar në Rregulloren për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik. Negative në këtë rast është mos publikimi i asnjë vendimi të Ministrit në faqen zyrtare të MM.

Në vendin e tretë rangohet Ministria e Drejtësisë (MD), e cila ka mbledhur 15 nga 24 pikë. Kjo Ministri ka publikuar të dhëna lidhur me zyrtarin për qasje në dokumente publike, Ministrin dhe gjithë Kabinetin e Ministrit. Edhe në këtë rast, publikimi i vendimeve të Ministres në faqen zyrtare të MD është bërë vetëm në raste përjashtuese. Po ashtu, problematike është edhe mungesa e respektimit të Rregullores për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik. Kjo pasi nga gjithsej 18 projekt koncept dokumente dhe projekt akte normative, kjo Ministri për konsultim publik ka publikuar vetëm 9 prej tyre, nga të cilat në tetë raste është respektuar afati minimal i konsultimeve publike.

7. Ministritë më jo-transparente

MKK është Ministria më jo transparente e Qeverisë. Në fakt, kjo Ministri nuk ka fare nivel të transparencës. Kjo pasi e njëjta nuk e ka fare të funksionalizuar faqen zyrtare, për të cilën arsye edhe nuk është e mundur matja e asnjë lloji transparence. Kështu, aktualisht, kjo Ministri funksionon pothuajse tërësisht e mbyllur nga publiku.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), ka grumbulluar vetëm 3 nga 24 pikë. Kjo Ministri nuk ka të dhëna adekuate për Kabinetin e Ministres si dhe nuk ka të publikuar asnjë vendim të nxjerrë nga Ministrja. Në raport me kërkesat për qasje në dokumente publike, sipas të dhënave të AIP, kjo Ministri nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit të përcaktuar me ligj në gjithsej 21 raste derisa në 18 raste qasja në dokumente publike është mundësuar vetëm

pas vendimit të AIP. Në asnjë rast, kjo Ministri nuk ka publikuar projekt koncept dokumentet apo projekt aktet normative në platformën e konsultimeve publike.

MSh ka grumbulluar vetëm 5 nga 24 pikë. Kështu, kjo është Ministria e tretë më jo transparente. Kjo Ministri nuk ka publikuar asnjë prej vendimeve të Ministrit. Në raport me kërkesat për qasje në dokumente publike, sipas të dhënave të AIP, kjo Ministri nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit të përcaktuar me ligj në gjithsej 14 raste derisa në 12 raste qasja në dokumente publike është mundësuar vetëm pas vendimit të AIP.

RANGIMI I INSTITUCIONEVE SIPAS TRANSPARENCËS

MBPZHR	MM	MD	ME
18	17	15	15
MINT	ZKM	MAShT	MAPL
14	13	13	12
MFPT	MZHR	MMPHI	MPB
11	11	9	9
MKRS	MSh	MPJD	MKK
7	5	3	0



8.2. Shtojca 2: Indikatorët e aplikuar për matjen e transparencës

1. A janë publikuar të dhënat bazë mbi institucionin ?
2. A është publikuar emri dhe kontaktet e zyrtarit për qasje në dokumente publike?
3. A janë të publikuara vendimet e Ministrave? (*Aplikohet vetëm për Qeverinë*)
4. A janë të publikuara të gjitha dokumentet në dy gjuhët zyrtare?
5. A janë publikuar të dhëna mbi emrat dhe kontaktet e zyrtarëve udhëheqës të institucionit, përfshirë edhe Kabinetet?
6. Sipas të dhënave të AIP, në sa raste institucioni nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor?
7. Sipas të dhënave të AIP, në sa raste qasja në dokumente publike është bërë e mundur vetëm pas vendimit të AIP?
8. A janë publikuar të gjitha dokumentet për konsultim në platformën e konsultimeve publike?
9. A është respektuar afati minimal i vendosjes së akteve në konsultim publik?